

## KONTRATE SHIT-BLERJE KUOTASH

Në Durrës sot më 01/07/2020 lidhet kjo kontratë shit-blerje kuotash, midis:

### PALËVE KONTRAKTUESE

**Z. AUREL QOPEKAJ:**

lindur më 15/07/1991 në Gjirokastrë, dhe banues në Durrës, mbajtës i Pasaportës BI0644287, lëshuar nga MB Tiranë më 19.08.2014, i cili më poshtë do të quhet, **Shitësi**.

*dhe*

**Z. ARTAN SELIMAJ:**

lindur më 14/07/1991 në Durrës, dhe banues në Durrës, mbajtës i Pasaportës BR0625975 lëshuar më 22.02.2011 nga MB Tiranë, i cili më poshtë do të quhet **Blerësi**.

Palët e mësipërme, janë persona madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### ***Kushte paraprake***

- Shitësi është ortak i vetëm në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar BUY SELL PROPERTY sh.p.k, person juridik me NIPT L822035040, me seli në adresën : Lagjja nr.4, Rruga 9 Maji, nr.pasurie 2/50-N1, zona kadastrale 8514, Durres.
- Kapitali themeltar është i ndarë në 1 pjesë (kuotë), e cila është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, me një vlerë nominale 500,000 Lekë.
- Shoqëria që prej datës 03/10/2018 ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Në përputhje me vendimin e ortakut, si dhe në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate, shitësi është i interesuar dhe ka shfaqur disponibilitetin e tij, që t'i shesë Blerësit Z. Artan Selimaj, 1 (një) kuotë të barasvlefshme me 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë BUY SELL PROPERTY sh.p.k.
- Blerësi është i interesuar dhe ka shfaqur disponibilitetin e tij që të blejë nga Shitësi, 1 kuotë që përfaqëson 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë BUY SELL PROPERTY sh.p.k, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë.

Meqënëse ekzistojnë kushtet e mësipërme paraprake, palët bien dakort si më poshtë

### **Neni 1 – Kushtet paraprake dhe Shtojcat**

Kushtet paraprake të sipërcituara dhe Shtojcat konsiderohen pjesë integrale e kësaj Kontrate ("Kontrata").

### **Neni 2 – Objekti i kontrates**

2.1 Me anën e kësaj kontrate, Shitësi dhe Blerësi kanë si qëllim të përcaktojnë kushtet dhe termat sipas të cilave shitësi i Transferon (i shet) Blerësit dhe ky i fundit pranon të blejë

1 kuotë që përfaqëson 33.33% (tridhjetë e tre dhe 33/100 përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë BUY SELL PROPERTY sh.p.k, person juridik me NIPT L822035040.

2.2 Kuotat objekt kontrate dhe çdo e drejtë e lidhur me to, janë të lira nga çdo barrë detyrimi.

### **Neni 3 - Çmimi i blerjes**

3.1 Kuotat objekt kontrate, shiten me çmimin total 166,650 (Njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë.

3.2 Blerësi deklaron se çmimin total të përcaktuar në paragrafin e mësipërm e ka marrë.

### **Neni 4 – Transferimi i kuotave**

Transferimi i kuotave të lartpërmenduara do bëhet efektiv, me ekzekutimin e kësaj kontrate duke kryer regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 5 - Deklarimet dhe Garancite e Shitesit**

5.1 Në datën e ekzekutimit të kësaj Kontrate Shitesi deklaron dhe garanton se:

- a) Shitesi është pronar i vetëm ligjor dhe perfitues i vetëm i Kuotave të përcaktuara në kushtet paraprake të sipërpermendura.
- b) Kuotat janë emetuar dhe shpërndarë në mënyrë të sakte dhe janë shlyer krejtësisht.
- c) Kuotat janë të lira nga çdo lloj barre apo hipoteke dhe shitesi ka të drejtë të plotë, pushtet dhe autoritet për t'i shitur, për t'i transferuar dhe shpërndarë Kuotat në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

5.2 Shitesi merr përsipër, premtim dhe garanton Blerësin se në momentin e ekzekutimit të kësaj kontrate ai zoteron:

- a) Titullin e plotë dhe të pakthyeshem ligjor të kuotave;
- b) Shitesi humbet pronësinë mbi kuotat objekt kontrate dhe nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi to, që prej momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate .

### **Neni 6- Deklarimet dhe Garancite e Blerësit**

Në datën e ekzekutimit të kësaj kontrate Blerësi deklaron dhe garanton se:

- a) Ka shlyer pagesën e plotë të kundërvleftës së kuotave ndaj Shitesit, me çmimin total të parashikuar më sipër në nenin 3.1, shumë e cila është paguar.

### **Neni 7 - Shpenzimet dhe Taksat**

Të gjitha shpenzimet ligjore, noteriale dhe kostot e tjera që kanë të bëjnë me lidhjen e Kontratës do të mbulohen nga Blerësi.

### **Neni 8 - Njoftimet**

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera të nevojshme ose që duhet të bëhen në kuadrin e kësaj Kontrate, duhet të bëhen në formë të shkruar dhe duhet të konsideron të dorëzuara nëse dërgohen personalisht ose nëpërmjet faksit (kur verifikohet marrja e tyre), e dërguar nëpërmjet postës rekomandë (me mandat kthimi) për Palët në adresat e përcaktuara për secilën palë në fillim të kësaj kontrate në dispozitën me titull "palët kontraktuese"

### **Neni 9- Ligji i zbatueshem**



Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj kontrate do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 10 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

10.1 Mosmarreveshjet e mundshme që lidhen me interpretimin, ecurinë, shkeljen, ndërprerjen ose zbatimin e kësaj Kontrate dhe anekseve përkatëse, do të zgjidhen nga palët me mirëkuptim.

10.2 Nëse kjo nuk arrihet, mosmarrëveshja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore, duke iu drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

#### **Neni 11- Forcat Madhore**

Asnjë prej paleve nuk do të konsiderohet përgjegjëse në qoftë se përmbushja e ndonjëres prej dispozitë të kësaj Kontrate do të vonohet ose nuk do të realizohet si rezultat i forcave madhore dhe sidomos si rezultat i arsyeve të mëposhtme: revolucionet, trazirat, lëvizjet popullore, luftërat, greva, zjarret, përmbytjet, shpronësimet, ose veprimet e qeverisë që kufizojnë lirinë personale apo ato të ndërmarrjes të secilës palë.

#### **Neni 12- Te ndryshme**

12.1 Kjo Kontrate e shkruar përben marrëveshjen e plotë ndërmjet paleve persa i përket objektit të kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, verbale apo të shkruara dhe të gjitha komunikimet e tjera të mëparshme ndërmjet paleve në lidhje me objektin në fjale.

12.2 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Kontrate, çdo ndryshim i kësaj Kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja Palët.

12.3 Të dyja palët janë dakord që afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen para një pale të tretë, përveç kur ligji e bën të detyrueshme.

12.4 Kjo Kontrate është përpiluar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga palët.

Shitësi:

1 Arnel Qopkeaj  


Blerësi:

1 Artan Selimaj  
